

# STATUTI I PARTISË POLITIKE

## SRPSKA DEMOKRATIJA/DEMOKRACIA SERBE

### Neni 1: Dispozitat themelore

Srpska Demokratija/Demokracia Serbe është një organizatë proaktive socio-politike e serbëve dhe komuniteteve të tjera që trashëgojnë parimet e lirisë, solidaritetit dhe demokracisë.

Puna e organizatës politike Demokracia Serbe është e fokusuar kryesisht në 10 komuna me shumicë serbe në Kosovë, si dhe në komunitetet tjera serbe në Kosovë.

Partia politike Demokracia Serbe regjistrohet në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme nr. 08/L-228.

Data e themelimit të partisë është 5 nëntor 2023 – kur u mbajt seanca konstitutive e Kuvendit të Demokracisë Serbe.

### Neni 2: Emri dhe selia e partisë

Partia përdor emrin e plotë dhe të shkurtuar. Emri i plotë i partisë është *Srpska demokratija* (Demokracia Serbe), ndërsa emri i shkurtuar i partisë është *SD* (akronimi). Partia e ka selinë në Mitrovicën e Veriut.

### Neni 3: Identiteti vizual

Identiteti vizual i partisë (flamuri, vula dhe logoja) përbëhet nga detaje vizuale që simbolizojnë kulturën dhe traditën e komunitetit serb në Kosovë, përkatësisht vlerat e mëposhtme:

- Harmonia,
- Solidariteti,
- Konformiteti,
- Dashuria për drejtësinë,
- Ndershmëria dhe
- Respektimi i diversitetit.

## Neni 4: Organizimi dhe përfaqësimi i partisë

Organi më i lartë i partisë është Kryesia, e cila përbëhet nga anëtarët më aktivë dhe më të shquar të partisë, të zgjedhur në Kuvendin e partisë.

Partia përfaqësohet në publik nga Kryetari i partisë dhe nënkryetarët e partisë (pra anëtarët e Kryesisë).

Kryetari i partisë cakton personin kontaktues dhe personin për operacionet financiare të partisë, me pëlqimin e Kryesisë.

Organet e partisë janë:

- Kuvendi — organi më i lartë i partisë që punon në seanca të rregullta dhe të jashtëzakonshme.
- Kryesia — e përbërë nga anëtarët më të shquar të partisë, të zgjedhur në Kuvendin e partisë.
- Kryetari — anëtari më i shquar i partisë, i zgjedhur në Kuvendin e Partisë.
- Këshilli mbikëqyrës — i përbërë nga anëtarë të partisë të cilët paraqesin raporte mbi operacionet financiare të partisë.
- Sekretari i përgjithshëm — personi i ngarkuar për mbledhjen e dokumentacionit ligjor dhe të tjera për qëllime të zgjedhjeve, si dhe për çështjet financiare të partisë.
- Këshillat komunale dhe lokale — njësi territoriale të partisë të ngarkuara për komunat, qytetet, fshatrat dhe vendbanimet periferike.
- Komisioni disiplinor — i përbërë nga anëtarë të partisë që vendosin nëse është shkelur Statuti apo Programi i partisë.

## Neni 5: Qëllimet e programit

Në punën e saj, partia angazhohet për arritjen e qëllimeve si në vijim:

- Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore, ekonomike, sociale dhe politike të komunitetit serb dhe komuniteteve tjera në Kosovë,
- Zhvillimi i demokracisë dhe frymës së solidaritetit,
- Përmirësimi i situatës socio-ekonomike dhe drejtësisë,
- Kultivimi i kulturës së dialogut në hapësirën publike, kundër gjuhës së urrejtjes mbi çdo bazë,

- Ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë fetare dhe kulturore,
- Mbrojtja e të drejtave kulturore,
- Mbijetesa e qëndrueshme, qëndrimi dhe kthimi i komunitetit serb, me theks në kthimin në zonat urbane,
- Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm,
- Angazhimi për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Për arritjen e këtyre qëllimeve programore, partia vepron në përputhje me kushtetutën dhe ligjet në fuqi dhe parimet e pranuar përgjithësisht të organizimit politik.

## Neni 6: Anëtarësimi dhe përfundimi i anëtarësimit në parti

Anëtar i partisë mund të jetë çdo qytetar i moshës madhore që gëzon të drejtën e votës në Kosovë dhe që:

- Nënshkruan formularin e aplikimit të Demokracisë Serbe,
- Shpreh dëshirën për të luftuar për një shoqëri solidare, të ndërgjegjshme në aspektin social dhe demokratike,
- Pranon Programin dhe Statutin e Demokracisë Serbe.

Anëtari i partisë nuk mund të jetë anëtar i një organizate tjetër politike.

Partia mban një regjistër të anëtarëve bazuar në nenin 17.2 të Rregullës Nr. 01/2013 për regjistrimin dhe funksionimin e partive politike në Kosovë.

Anëtarët e partisë paguajnë kuotën e anëtarësimit në masën që mund ta përballojnë, por ajo nuk mund të kalojë shumën prej 20 euro në vit. Kryesia mund të lirojë nga pagesa e anëtarësimit ata anëtarë të partisë që për shkak të gjendjes së tyre financiare nuk kanë mundësi të paguajnë kuotën e anëtarësimit.

Pas nënshkrimit të formularit të aplikimit, Kryesia vendos për pranimin e anëtarëve të rinj.

Anëtarësimi në parti përfundon me:

- Vdekjen e një anëtari,
- Përrjashtimin ose largimin nga partia,
- Fshirjen për shkak të anëtarësimit në një parti apo organizatë tjetër politike.

## Neni 7: Të drejtat e anëtarëve

Të gjithë anëtarët e partisë kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe pa dallim në aktivitetet e partisë, të shprehin lirisht mendimet e tyre dhe të japin propozime që nuk bien ndesh me Programin dhe Statutin e partisë, ose me qëllimet dhe aktet tjera ligjore.

Të gjithë anëtarët e partisë mundën lirshëm të:

- Të marrin informacion për aktivitetet e partisë,
- Të përcaktojnë politikën e partisë në mënyrë demokratike,
- Të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e partisë,
- Të marrin mbrojtjen e partisë nëse kërcënohen në çfarëdo mënyre për shkak të kryerjes së veprimtarive të partisë.

## Neni 8: Obligimet e anëtarëve

Të gjithë anëtarët e partisë obligohen që:

- Të respektojnë Programin dhe Statutin e partisë, si dhe vendimet politike dhe qëllimet programore,
- Të dalin në zgjedhje dhe të votojnë për kandidatët e partive,
- Të angazhohen në përmirësimin e reputacionit të partisë,
- Të avokojnë për suksesin e partisë në fushatë zgjedhore,
- Të përmbushin obligimet tjera nga Statuti, Programi dhe aktet tjera të partisë.

Nëse Kryesia e partisë konstaton shkelje të rëndë të Statutit dhe Programit të partisë, ai anëtar do të përjashtohet nga anëtarësia pasi të përgjigjet para Komisionit Disiplinor të partisë.

Anëtarët e partisë nuk janë përgjegjës për borxhet e partisë.

## Neni 9: Kompetencat e Kuvendit

Kuvendi i partisë:

- Miraton Programin dhe Statutin e partisë dhe miraton ndryshimet dhe plotësimet e tyre,
- Përcakton udhëzime për veprimtarinë politike të partisë,
- Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, anëtarët e Kryesisë, anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe Këshillit mbikëqyrës të partisë,

- Merr vendime për shpërbërjen, shkrirjen dhe bashkimin e partisë me organizata të tjera politike.

Kuvendi i Demokracisë Serbe takohet të paktën një herë në tre muaj, por edhe më shpesh sipas nevojës.

## Neni 10: Vendimmarrja në Kuvend

Kuvendi mund të marrë vendime të plotfuqishme vetëm nëse në seancën e rregullt ose të jashtëzakonshme janë të pranishëm shumica e delegatëve.

Kuvendi merr vendime sipas sistemit të dy të tretave të delegatëve të pranishëm kur vendoset për:

- Ndryshimet në Programin dhe Statutin e partisë,
- Shkarkimin e Kryetarit dhe anëtarëve të Kryesisë së partisë.

Seancën e Kuvendit të partisë e kryeson Kryetari ose anëtari i autorizuar i Kryesisë së partisë.

Një shumicë prej dy të tretave të Kuvendit është e nevojshme nëse vendoset shpërbërja, shkrirja dhe bashkimi i partisë me organizata të tjera politike.

## Neni 11: Kryesia e partisë

Kryesia e Demokracisë Serbe është organi më i lartë vendimmarrës ndërmjet mbajtjes së dy seancave të Kuvendit të partisë dhe përbëhet nga një numër tek i anëtarëve më të shquar të partisë të zgjedhur në Kuvend.

Sipas funksionit, Kryetari i partisë është edhe Kryetar i Kryesisë.

Kryesia takohet të paktën një herë në muaj. Përbërja e Kryesisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të dy të tretave të Kuvendit të partisë.

Funksioni i një anëtari të Kryesisë - dmth. nënkryetarit - përfundon me skadimin e mandatit për të cilin është zgjedhur, dorëheqjen ose përfundimin e anëtarësimit në parti. Mandati i anëtarit të Kryesisë zgjat dy vjet.

Kryesia e partisë:

- Përcakton politikën dhe veprimtarinë e partisë,
- Përgatit seancat dhe zbaton vendimet e Kuvendit,
- Propozon ndryshime në Statutin dhe Programin e partisë,

- Analizon rezultatet e zgjedhjeve,
- Merr vendim për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe programin zgjedhor të partisë,
- Vendos për koalicionet parazgjedhore dhe paszgjedhore,
- Përcakton listën zgjedhore për zgjedhjen e asambleistëve dhe deputetëve,
- Merr vendim për zëvendësimin dhe shkarkimin e Kryetarit të partisë,
- Zgjidh konfliktet dhe problemet lidhur me kompetencën e organeve partiake.

Seanca e Kryesisë thirret me shkrim ose në mënyrë elektronike. Kryetari i partisë (i cili është edhe Kryetar i Kryesisë) duhet të caktojë seancën e Kryesisë kur një gjë të tillë e kërkojnë të paktën gjysma e anëtarëve të Kryesisë.

Kryesia e partisë është e autorizuar të miratojë rregulloren e punës që duhet të zbatohet në seancat e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit të partisë, që përfshin sigurimin e kuorumit, përcaktimin e rendit të ditës dhe mënyrën e vendimmarrjes

## Neni 12: Kryetari i partisë

Mandati i Kryetarit të partisë zgjat dy vjet, pas të cilit Kryesia dhe Kuvendi votojnë sërish për rizgjedhjen e Kryetarit të vjetër ose zgjedhjen e Kryetarit të ri.

Për punën e tij, Kryetari i partisë përgjigjet para Kryesisë dhe Kuvendit.

Nëse Kryetari nuk respekton Statutin, Programin dhe parimet e përgjithshme të partisë, Kryesia mund ta suspendojë Kryetarin e partisë me shumicë votash 50% + 1 votë, pas së cilës Kuvendi voton sërish për Kryetar të ri.

Kryetari i partisë zgjidhet dhe shkarkohet nga Kuvendi me votim të fshehtë. Kandidati për Kryetar partie propozohet nga së paku dy Këshilla komunale, shumica e anëtarëve të Kryesisë së partisë ose me shumicë të dy të tretave të Kuvendit të partisë.

Propozimet për kandidatët për Kryetar partie, propozuesit i dorëzojnë me shkrim ose në mënyrë elektronike Kuvendit të Partisë në adresën elektronike zyrtare të partisë:

[info@srpskademokratija.org](mailto:info@srpskademokratija.org).

Kryetar i partisë zgjidhet kandidati që merr 50% + 1 votë nga delegatët e pranishëm në Kuvend.

Në rast se janë propozuar më shumë se dy kandidatë, por asnjëri prej tyre nuk ka marrë shumicën e kërkuar të votave, përsëriten zgjedhjet ndërmjet dy kandidatëve me numrin më të madh të votave.

Kryetari i partisë:

- Kontrollon punën e organeve partiake,
- Thërret seancat e Kuvendit dhe Kryesisë dhe i kryeson ato ose ua delegon kryesimin anëtarëve të tjerë të Kryesisë.
- Deleton përgjegjësi tek zyrtarët e tjerë të partisë,
- Kujdeset për çështjet financiare të partisë,
- Kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të Kuvendit dhe të Kryesisë në përputhje me Statutin, Programin dhe parimet e përgjithshme të partisë,
- Kryen detyra të tjera që i janë besuar nga Kuvendi dhe Kryesia e partisë.

### Neni 13: Këshilli mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës është këshilli mbikëqyrës dhe kontrollues i partisë, i përbërë nga Kryetari i Këshillit dhe dy anëtarë, të cilët zgjidhen dhe shkarkohen nga Kuvendi i partisë.

Mandati i anëtarit të Këshillit mbikëqyrës është dy vjet.

Nëse është e mundur, anëtarët e Këshillit mbikëqyrës duhet të jenë juristë me profesion.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit mbikëqyrës:

- Kontrolli i operacioneve financiare, të hyrave dhe shpenzimeve të partisë,
- Dorëzimi i raportit vjetor për çështjet financiare dhe punën e vet në Kuvend dhe Kryesinë e Partisë.

### Neni 14: Sekretari i përgjithshëm

Sekretari i përgjithshëm është anëtar i partisë, i cili zgjidhet nga Kryesia me propozimin e Kryetarit ose të shumicës së anëtarëve të Kryesisë së partisë.

Mandati i Sekretarit të përgjithshëm zgjat dy vjet.

Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e çështjeve administrative dhe të ngjashme të partisë, si dhe për mbajtjen e regjistrit të anëtarëve — dhe për punën e tij i përgjigjet Kryesisë së partisë.

### Neni 15: Këshillat komunale dhe lokale

Këshillat komunale të partisë zbatojnë politikën e partisë në territorin e komunës së caktuar.

Autorizimet/kompetencat e Këshillave komunale:

- Promovimi i vlerave dhe politikave të partisë në komunë,
- Anëtarësimi i anëtarëve të rinj,
- Emërimi i delegatëve në Kuvendin zgjedhor të partisë,
- Zbatimi i vendimeve të organeve më të larta të partisë,
- Organizimi dhe zbatimi i aktiviteteve zgjedhore,
- Kryerja e aktiviteteve të tjera të besuara nga Kryesia dhe Kuvendi.

Përbërja e Këshillave komunale:

- Kryetari i Këshillit komunal,
- Nënkryetarët e Këshillit komunal,
- Sekretari i Këshillit komunal, dhe
- Kryetarët e këshillave lokale në komunën e caktuar.

Kryetari i Këshillit komunal zgjidhet me shumicë votash në bazë të sistemit 50% + 1 votë nga numri i anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e Këshillit komunal.

Mandati i Kryetarit të Këshillit komunal zgjat dy vjet dhe mandati i tij përfundon me dorëheqje, përfundim të anëtarësimit në parti ose shkarkim nga Këshilli komunal.

Këshillat lokale të partisë zbatojnë politikën e partisë në një komunitet të caktuar lokal (vendbanim periferik, rrethi i qytetit, njësi zgjedhore ose fshat).

Autorizimet (kompetencat) e Këshillave lokale:

- Promovimi i vlerave dhe politikave të partisë në regjionin e komunitetit lokal,
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj,
- Zbatimi i vendimeve të organeve më të larta të partisë,
- Organizimi dhe zbatimi i aktiviteteve zgjedhore.

Kryetari i Këshillit lokal zgjidhet me shumicë votash në bazë të sistemit prej 50% + 1 votë të numrit të anëtarëve të pranishëm të Këshillit lokal.

Mandati i Kryetarit të Këshillit lokal zgjat dy vjet dhe mandati i tij përfundon me dorëheqjen, përfundimin e anëtarësimit në parti ose shkarkimin nga Këshilli lokal.



## Neni 16: Organet këshilluese dhe profesionale

Anëtarët e organeve profesionale dhe këshilluese jo domosdoshmërisht duhet të jenë anëtarë të partisë, por ata mund t'i paraqesin propozime Kryesisë dhe Kuvendit për përmirësimin e Programit dhe parimeve të përgjithshme të veprimtarisë së partisë. Si rregull, anëtarët e organeve profesionale dhe këshilluese janë profesionistë dhe/ose njohës të gjendjes në teren.

Anëtarët e organeve këshilluese dhe profesionale mundën - si figura jopartiake - të jenë kandidatë në zgjedhje, nëse miratohen nga shumica e dy të tretave të Kuvendit të Demokracisë Serbe.

## Neni 17: Financimi dhe disponimi me mjetet financiare të partisë

Partia përfiton mjete financiare nga:

- Kontributet vullnetare,
- Tarifat e anëtarësimit,
- Zotimet,
- Dhuratat,
- Buxheti i Fondit për mbështetjen e punës së partive politike në Kuvendin e Kosovës,
- Burime të tjera në përputhje me ligjet në fuqi.

Shuma e kontributit vullnetar nuk mund të ndikojë në mënyrë të favorshme ose të disfavorshme në statusin e anëtarit ose donatorit (dhuruesit vullnetar). Më saktësisht, të gjithë anëtarët kanë të drejta të barabarta në përputhje me Statutin dhe Programin, pavarësisht nga kontributi i tyre financiar.

Pasuria e partisë është e pandashme dhe disponohet nga personi i autorizuar për operacione financiare me pëlqimin e Kryesisë së partisë. Ky mund të jetë i njëjti person i caktuar si Sekretar i përgjithshëm i partisë.

Sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për operacionet financiare, mbajtjen e kontabilitetit dhe vendosjen e kontakteve me autoritetet kompetente në Kosovë.

Operacionet materiale - financiare të partisë janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Këshilli mbikëqyrës i partisë është përgjegjës për kontrollin e operacioneve financiare të partisë dhe paraqitjen e raporteve mbi operacionet financiare të partisë.

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve është pjesë integrale e raportit vjetor që partia ia dorëzon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës.

## Neni 18: Miratimi, ndryshimet dhe plotësimet në Programin, Statutin dhe aktet e përgjithshme të partisë

Ndryshimet e Programit, Statutit dhe akteve të përgjithshme të partisë mund të inicohen nga Kryesia, Kryetari ose Kuvendi i Partisë me shumicë prej dy të tretave të delegatëve të pranishëm - me shkrim ose në mënyrë elektronike në [info@srpskademokratija.org](mailto:info@srpskademokratija.org).

Debati për ndryshime në Program, Statut dhe akte të përgjithshme zgjat tri (3) ditë. Kryesia e partisë është e obliguar që propozimin për ndryshimin/plotësimin e aktit ta përcaktojë dhe t'ia dërgojë Kuvendit të partisë për miratim.

Kuvendi vendos për Programin e ri dhe për Statutin e ri në tërësi me dy të tretat e votave të delegatëve.

Ndryshimet në Statutin e partisë mund të inicohen dhe të miratohen me shumicë prej dy të tretave të anëtarëve të Kuvendit të partisë dhe pas një diskutimi treditor në organet e partisë.

Kuvendi i partisë cakton dy anëtarë të Komisione të ngarkuar me hartimin e propozimeve për ndryshime në Statut dhe atë propozim ia paraqet Kryesisë për shqyrtim. Pas formulimit të propozimit, Kryesia ia paraqet propozimin Kuvendit për votim.

## Neni 19: Përfundimi i punës dhe mënyra e disponimit të pasurisë së partisë në rast të përfundimit të punës

Kuvendi i partisë merr vendim për përfundimin e punës së partisë, por vetëm me propozimin e shumicës prej dy të tretave të Kryesisë, Kuvendit ose me iniciativën e Kryetarit të partisë.

Nëse partia pushon së funksionuari, pasuria e partisë u dorëzohet anëtarëve të partisë.

Personi i cili në kohën e përfundimit të funksionimit të partisë ka mbajtur pozitën e Kryetarit të partisë ka autorizim të ndërmarrë veprimet juridike me qëllim të pagesës së borxheve të partisë dhe bartjes së të drejtave pronësore të partisë të anëtarët e partisë.

## Neni 20: Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Çështjet që nuk janë të përcaktuara me këtë Statut rregullohen me akte të tjera të partisë, si rregullorja e punës dhe rregulloret, të cilat miratohen me shumicë prej dy të tretave të Kryesisë së partisë. Aktet e tjera të partisë miratohen nga organet e partisë në përputhje me kompetencat e tyre dhe ligjet në fuqi.

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit.

Në Mitrovicën e Veriut,

Më 5 nëntor 2023

**KRYETAR**

Aleksandar Arsenijević

**KRYESUESI I KUVENDID KONSTITUTIV**

Stefan Veljković

